



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:184578

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05765868

A.C.nr.10117/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci , anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.B. nga fshati B..., Komuna Suharekë, të cilin e përfaqëson me autorizim R.G., avokat me seli në Komuna Suharekë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Agjensioni Pyjor i Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura e Shtetit përkatësisht avokate Nazmije Aliu nga Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore për kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.716/20 datë 12.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Agjensioni Pyjor i Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.716/20 datë 12.10.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.716/20 datë 12.10.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon: *“...APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.B. nga fshati B..., komuna Suharekë. DETYROHET e paditura Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës – Agjensioni Pyjor i Kosovës,*

në Prishtinë , që paditësit t'ia paguaj në emër të kompensimit të të ardhurave personale dhe kontributeve për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës nga muaji Dhjetor 2009 deri në muajin Shtator 2013, shumën e përgjithshme prej 25,027.72 € (njëzet e pesë mijë e njëzetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e dy cent) euro, me kamatë ligjore 8 % nga dita e largimit të paditësit nga marrëdhënia e punës. OBLIGOHET e paditura që paditësit t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në shumë e përgjithshme prej 2,902.00 € (dymijë e nëntë qind e dy) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm....”.

Kundër aktgjykimit C.nr.716/20 datë 12.10.2021, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, të ndryshoj aktgjykimin e goditur me këtë ankesë ashtu që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe nenit 195 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi A.B., nga fshati B..., Komuna Suharekë, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës – Agjensioni Pyjor i Kosovës, në Prishtinë, për kompensimin e të ardhurave personale për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës.

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, ka marrë aktgjykim C.nr.396/16 datë 21.03.2017, me të cilin ka vendosur që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

Kundër aktgjykimit C.nr.396/16 datë 21.03.2017 ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë ka marrë aktvendim AC.nr.4023/17 datë 16.10.2020, me të cilin ka vendosur që të aprovet si e bazuar ankesa e paditësit dhe e ka prishur aktgjykimin C.nr.396/16 datë 21.03.2017, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë, pas kthimit të lëndës në rivendosje ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 12.10.2021, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se: “... *Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pasi që e paditura në mënyrë të kundërligjshme dhe pa prova materiale ka larguar paditësin nga marrëdhënia e punës me vendimet e saj të njëpasnjëshme duke mos respektuar fare vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A 02(216)2009 i dt.04.12.2009, vendim i cili është vërtetuar në të gjitha instancat gjyqësore si i drejtë dhe si i tillë i ekzekutueshëm. Ndërsa sa i përket lartësisë së kompensimit për shkak të largimit të paligjshëm nga marrëdhënia e punës gjykata gjithnjë pati parasysh ekspertizën e ekspertit të licencuar financiar S.B., e që në kuptim të nenit 136.1 i cili thotë “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij” dhe nenit 140 i cili rregullon ekzistimin e fajësisë e që thotë “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia” të LMD-së...”.*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se paditësi nga e paditura është larguar nga marrëdhënia e punës pa të drejtë, këtë fakt e ka konstatua edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës me vendimin A 02(216)2009 datë 04.12.2009, po ashtu edhe Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykim A.nr.426/10 datë 10.07.2013, ka vendosur që me i anulue vendimet nr.1541/4 datë 30.11.2009 i Komisionit disiplinor të Ministrisë, Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, si dhe vendimin 193/5 datë 04.02.2010, të Komisionit për ankesa të Ministrisë, Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, dhe ka vendosë me lanë në fuqi vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A 02(216)2009 datë 04.12.2009, po ashtu Aktgjykimi A.nr.426/10 datë 10.07.2013 është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin A.A.nr.296/2013 datë 18.12.2013, ndërsa nga ekspertiza e ekspertit financiar I.B., i cili e ka përlllogaritur shumën e të ardhurave personale dhe shtesat e tjera dhe atë trusti dhe tatimet nga muaji Dhjetor 2009 deri në muajin Shtator 2013 ekspertizë e hartuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës në të njëjtën janë llogaritur të ardhurat personale-pagat neto në shumë prej 18,738.70 Euro, kamata për pagat e papaguara 3,229.11 Euro, kontributi i trustit pensional 2,076,06 Euro, si dhe tatimi në të ardhurat personale 983.85 Euro e që gjithsej kapin shumën prej 25,027.72 Euro, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Në nenin 80 par.1.1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ndër të tjera thuhet se “ *Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre*

dëmshpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit.

Po ashtu edhe në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në rastin Klass kundër Gjermanisë në Aktgjykimin e 6 shtatorit 1978 ndër të tjera thuhet se *“kur një person konsideron se është paragjykuar përmes një akti për të cilin pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të këtë në dispozicion një mjet juridik para autoriteteve shtetërore, që do i mundësojë zgjidhjen e kërkesës së tij dhe, nëse duhet, ofrimin e kompensimit”*, ndërsa në nenin 13 të Konventes Evropiane për të drejtat e njeriut ndër të tjera thuhet se *“...Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar...”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka llogaritur shumën e aprovuar dhe e ka detyruar të paditurën që t'ia paguaj paditësit në emër të kompensimit të të ardhurave personale dhe kontributeve për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës nga muaji Dhjetor 2009 deri në muajin Shtator 2013, shumën e përgjithshme prej 25,027,72 (njëzet e pesë mijë e njëzetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e dy cent) Euro, me kamatë ligjore 8 % nga dita e largimit të paditësit nga marrëdhënia e punës.

Sa i përket vendosjes nga gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, nuk ka pasur pretendime ankimore.

Lidhur me pretendimet tjera ankimore të paditurës të parashtruara në ankesë, Gjykata e Apelit i mori parasysh dhe gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:184578
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05765868

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.10117/2021 datë 20.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi